



KOLEGJI ESLG

PROCESVERBALI I TAKIMIT TË SENATIT

Në mbledhjen e mbajtur me korrespondencë, Senati i Kolegjit më 07.04.2021 miraton si në vijim:

- Propozimin e Komisionit për Rishikim të Kurrikulumit për përfshirjen e aktivitetit interdisciplinar në semestrin veror 2020-2021 në programin Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA);
- Anëtarët e Komisionit që do të kryejë hartëzimin e rezultateve të mësimnxënies me metodat e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit të cilët janë në këtë përbërje: Visar Hoxha, Jehona Hoxha, Islam Hasani, Viola Brahusi, Andi Belegu dhe Gent Sejdiu;
- Anëtarët e Komisionit për Thirrje Akademike (Komisionit të Habilitimit) në nivel të Kolegjit ESLG në këtë përbërje: Prof. Dr. Visar Hoxha, Prof. Asistent Veli Lecaj, Prof. Asistent Hazer Dana dhe Prof. Asoc. Dr. Sabri Sadiku;
- Anëtarët e Komisionit për Rishikimin e Kurrikulës për shqyrtimin e futjes së më shumë opsioneve të lëndëve zgjedhore në planprogramin e programit master në këtë përbërje: Jehona Hoxha, Viola Brahusi, Islam Hasani;
- Anëtarët e Komisionit për Shiqimin e Kurrikulës së programit master për të parë sasinë dhe peshën e implementimit të hulumtimit në kuadër të lëndëve master dhe kompatibilitetin e saj me fushat tematike të aprovuara me Planin e Hulumtimit në këtë përbërje: Visar Hoxha dhe Hazer Dana;
- Themelimin e Programit Tutorët që mësojnë si të mësohet (Learning to Learn Tutors) të përbërë nga studentët e shkëlqyeshëm të cilët marrin përsipër të turojnë studentët që ngecin. Në programin Tutorët që Mësojnë si të Mësohet janë përzgjedhur studentët e shkëlqyeshëm të semestrit dimëror 2020—2021: Viola Brahusi dhe Blerta Nahi Demjaha. Lista e studentëve që ngecin do të dërgohet nga Zyra për Cilësi;
- Themelimin e Programit për Ligjërime/Udhëzim Shtesë për kompletimin e suksesshëm të kërkesave të lëndës për studentët që ngecin, që duhet të mbahet nga profesorët përkatës në ato lëndë ku niveli i kalueshmërisë në lëndë është më i ulët se 50 %;
- Themelimin e Programit për Vlerësim Kolegial (Peer Assessment Program) ku studentët me arritje mbi optimale do të nxisin, udhëzojnë dhe motivojnë studentët me arritje sub-optimale të rrisin interesin në studime. Në programin e Vlerësimit Kolegial (Peer Assessment Program) janë përzgjedhur studentët e shkëlqyeshëm



KOLEGJI ESLG

- të semestrit dimëror 2020—2021: Etnik Arifaj dhe Taulant Blakaj. Lista e studentëve që ngecin do të dërgohet nga Zyra për Cilësi;
- Raportin e dalë nga Seancat Dëgjimore të Zyrës së Cilësisë me mostrën representative të secilit grup të studentëve në të cilën kanë marrë pjesë studentët me arritje optimale dhe studentët që ngecin;
 - Hartimin e rasteve të studimit në lëndët përkatëse të ngjashme me ato të Harvard Business School në gjuhën shqipe dhe rasteve interdisciplinare të studimit në bashkëpunim me Bordin Industrial;
 - Hartimin e Aktivitetit Interdisciplinar për 4 lëndët e semestrit veror Materialet e Qëndrueshme Ndërtimore, Ndërtesat e Energjisë, Ndërmarrësia në Paluajtshmëri dhe Teknikat Kuantitative të Investimeve në Paluajtshmëri;

Anëtarët e Senatit:

Prof. Dr. Visar Hoxha

Prof. Asistent Dr. Veli Lecaj

Prof. Asistent Dr. Islam Hasani

Prof. Asistent Dr. Mersiha Kacamakovic

M.Sc. Jehona Hoxha

Prof. Asistent. Dr. Hazer Dana

Viola Brahushi, Përfaqësuese e studentëve

Blertha Nahi Demjaha, Përfaqësuese

M.Sc. Elita Çeku

Annex of Innovation Campus

T: +383 38 602 515

T: +383 45 456 666

E: info@eukos.org